

**Emërtimi dhe Forma
ligjore**

Optima Communication shpk

NIPT -i

K71903025A

Adresa e Selisë

Rr. "Ibrahim Rugova"

Sky Tower, 5/4

TIRANA-ALBANIA

Data e krijimit

26.12.2006

Nr. i Regjistrimit Tregtar

Veprimtaria Kryesore

Ofrimi i shërbimeve grafike, dizejnim, editori, dizejnim faqe web,
grafike multimediale etj.

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standardit Kombëtar te Kontabilitetit Nr.2 dhe
Ligjit Nr. 9228 Date 29.04.2004 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare)

2014

Pasqyra Financiare janë
individuale

PO

Pasqyra Financiare janë te konsoliduara

-

Pasqyra Financiare janë te shprehura ne

LEK

Pasqyra Financiare janë te rrumbullakosura ne

LEK

Periudha Kontabël e Pasqyrave Financiare

Nga 01.01.2014

Deri 31.12.2014

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare

25.03.2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
BILANCI	
AKTIVI.....	3
PASIVI	3
TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET	4
PASQYRA E FLUKSIT MONETAR (CASH FLOW).....	5
PASQYRA E LËVIZJES SE KAPITALIT.....	6
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE.....	7-16
PASQYRA STATISTIKORE.....	17-19

PASQYRAT FINANCIARE 2014

	Shënime	Më 31 dhjetor 2014	Më 31 dhjetor 2013
Aktive			
Aktive afatgjata materiale	8	5,185,360	6,558,902
Aktivet materiale afatgjata të investuara			-
Kapital i papaguar	9		-
Totali i aktiveve afatgjata		5,185,360	6,558,902
 Inventarë	6	-	-
Kërkesa për arkëtim nga debitorët	5	11,000,591	18,215,175
Parapagime	7	279,000	279,000
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	4	4,664,797	4,462,685
Totali i aktiveve afatshkurtra		15,944,388	22,956,860
Totali i aktiveve		21,129,748	29,515,762
 Detyrime dhe kapitale të veta			
Kapitali i regjistruar	15	100,000	100,000
Kapitali i pa-regjistruar			
Kapitali i pa-paguar			
Rezerva			
Fitim /Humbje të mbartura dhe Ushtrimore	20	18,451,575	18,214,021
Totali i kapitaleve të veta		18,551,575	18,314,021
 Detyrime financiare – afatgjata	13		-
Detyrime tatimore të shtyra	14		-
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
 Furnitorë dhe detyrime të tjera	11	2,431,230	10,693,273
Detyrime financiare – afatshkurtra per taksa	12	146,943	508,468
Detyrime financiare – afatshkurtra	10		-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		2,578,173	11,201,741
Totali i detyrimeve dhe kapitaleve të veta		21,129,748	29,515,762

Shënimet bashkangjitur nga 1 deri ne 20 janë pjese integrale e këtyre pasqyrave financiare.

OPTIMA COMMUNICATION SHPK
PASQYRAT FINANCIARE 2014

(të gjitha vlerat janë të shprehura në LEKE, derisa nuk pasqyrohet ndryshe)

PASH 2014	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
Te ardhura nga Sherbimi	16	10,163,449	24,784,257
Total te Ardhurat		10,163,449	24,784,257
Shpenzime lidhur me përfitimet e punonjësve	17	(3,472,820)	(12,441,534)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	18	(4,269,220)	(17,276,495)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	8	(1,376,990)	(955,837)
Shpenzime të tjera, neto	17	(642,522)	(1,304,591)
Fitimi nga veprimtaritë shfrytëzuese para kostove financiare		401,897	(7,194,200)
Të ardhura financiare	19	48,580	1,758
Shpenzime financiare	19	(9,341)	(18,653)
Komisione Banke	19	(65,508)	(78,942)
Fitimi para tatimit		(26,269)	(95,837)
E ardhura tatimore		375,628	(7,290,037)
		138,073	-
Fitimi (Humbja) e Vitit	20	237,555	(7,290,037)

Shënimet bashkangjitur nga 1 deri ne 20 janë pjese integrale e këtyre pasqyrave financiare

OPTIMA COMMUNICATION SHPK
PASQYRAT FINANCIARE 2014

(të gjitha vlerat janë të shprehura në LEKE, derisa nuk pasqyrohet ndryshe)

Flukse monetare nga veprimtari shfrytëzuese:	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
Fitimi pas tatimit	375,628	(7,290,037)
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	1,376,990	955,837
Humbjen nga Kembimet valutore	(35,682)	18,653
Të ardhurat nga interesi	(576)	-
Shpenzimet për interesa	-	-
Shpenzimet për Tatim fitim	-	-
<i>Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues</i>	<u>1,716,360</u>	<u>(6,315,547)</u>
Zvogëlimi / (ritja) e inventarëve	-	-
Zvogëlimi / (ritja) e kërkesave për arkëtim	7,396,816	294,468
(Zvogëlimi) / ritja e llogarive të pagueshme	<u>(8,623,568)</u>	<u>6,191,360</u>
	<u>489,608</u>	<u>170,281</u>
Interes i paguar		-
Interes i arkëtuar		-
Tatim fitimi i paguar	<u>(287,496)</u>	
Paraja neto nga aktivitetet operative	<u>202,112</u>	<u>170,281</u>
 Flukse monetare nga veprimtaritë investuese:		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale		(5,539,589)
Blerje e aktiveve afatgjata jo-materiale		
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Paraja neto nga aktivitetet investuese	<u>-</u>	<u>(5,539,589)</u>
 Flukse monetare nga veprimtaritë financuese:		
Arkëtime nga derdhja e kapitalit	0	0
Arkëtime nga huamarrjet dhe qiratë financiare	0	
Arkëtime nga përdorimi i kredisë kufi	0	
Paraja neto veprimtaritë financuese	<u>0</u>	<u>0</u>
 Pakësimi neto i mjeteve monetare	<u>202,112</u>	<u>-5,369,308</u>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	<u>4,462,685</u>	<u>9,831,993</u>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	<u>4,664,797</u>	<u>4,462,685</u>

Shënimet bashkangjitur nga 1 deri ne 20 janë pjese integrale e këtyre pasqyrave financiare

OPTIMA COMMUNICATION SHPK
PASQYRAT FINANCIARE 2014

(të gjitha vlerat janë të shprehura në LEKE, derisa nuk pasqyrohet ndryshe)

PASQYRA E KAPITALIT	Kapitali i regjistruar	Rezerve ligjore	Rezerva te tjera	Rezerva e rivleresimit	Fitime te mbajtura	TOTAL
Balanca e hapjes						
Me 01 Janar 2013	100,000				25,504,057	25,604,057
Axhustime per vitin e kaluar	-	-	-	-	-	-
Balanca e hapjes e axhustuar	100,000	-	-	-	25,504,057	25,604,057
01 Janar 2013						-
Fitimi /(Humbja) e vitit	-	-	-	-	(7,290,037)	(7,290,037)
Te ardhura te tjera gjithperfshtese	-	-	-	-	-	-
Totali I te ardhurave gjithperfshtese	100,000	-	-	-	18,214,020	18,314,020
Transferim ne reserve	-			-		-
Dividente te paguar	-	-	-	-		-
Me 31 Dhjetor 2013	100,000	-	-	-	18,214,020	18,314,020
						-
Me 01 Janar 2014	100,000	-	-	-	18,214,020	18,314,020
Fitimi/ (Humbja) e vitit	-	-	-	-	237,555	237,555
Shtim Kapitali		-	-	-	-	-
Totali I te ardhurave gjithperfshtese	100,000	-	-	-	18,451,575	18,551,575
Transferim ne reserve	-					-
Dividente te paguar	-	-	-	-		-
Me 31 Dhjetor 2014	100,000	-	-	-	18,451,575	18,551,575

Shënimet bashkangjitur nga 1 deri ne 20 janë pjese integrale e këtyre pasqyrave financiare

Administrator
GLON BAKALLI



SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Optima Communication sh.p.k. (referuar si "Optima" ose "Shoqëria") është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) më datë 26 dhjetor 2006.

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit 9901, datë 14 prill 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe nga statuti i saj. Aktiviteti i Shoqërisë konsiston në ofrimin e shërbimeve grafike dizënjim, editori, dizënjim faqe web, grafike multimediale, fushata promovionale prodhimesh, fushata sociale, packaging, reklama, ilustrime, broshura, katalogje elektronike dhe aktivitete të tjera në fushën e grafike dizënjim.

Shoqëria zotërohet 40 % nga ortakut Z. Glon Bakalli, 40 % nga ortakut Z. Ilir Daci dhe 20 % nga ortakut Z. Niko Qirici.

Vlera e kapitalit themeltar është 100.000 Lekë, e ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 1.000 lekë për kuotë.

Administrator i Shoqërisë është Z. Glon Bakalli.

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Përputhshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të shpallura më datë 15 qershor 2006 në përputhje me Ligjin 9228, datë 29 prill 2004 të ndryshuar me ligjin 9477, datë 9 shkurt 2006.

2.2 Parimi i vijimësisë

Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë më 31 dhjetor 2014 janë paraqitur duke u nisur nga supozimi se Shoqëria do të jetë në gjendje t'i arkëtojë dhe t'i shlyejë këto të drejta dhe detyrime gjatë rrjedhës normale të biznesit.

2.3 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe, nëse ka të tilla.

2.4 Periudhat krahasimore

Të dhënat e periudhave të mëparshme janë riklasifikuar për t'i bërë ato të krahasueshme me paraqitjen e të dhënave të periudhës ushtrimore.

2.5 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.6 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. Politikat kontabël kryesore

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në fillim dhe në fund të periudhës. Të drejtat dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit të përdorura në konvertimin e aseteve dhe detyrimeve monetare në monedhë të huaj janë:

	31 dhjetor 2014
Euro/Lek	140.14

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë joderivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë joderivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç sa më poshtë. Për instrumentat e mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë joderivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe mospagesa apo pagesa e vonuar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua me interes të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

Të tjera

Instrumenta të tjerë joderivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Instrumentet financiare klasifikohen si asete afashkurtra me përjashtim të rasteve kur shoqëria ka një të drejtë pa kusht për ta shtyrë pagesën e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël për shkak ose të natyrës së tyre afatshkurtër ose të normës së interesit e cila i përafrohet normës së tregut.

3.3 Aktive të qëndrueshme jomateriale

Aktivet e qëndrueshme jomateriale që kanë një jetë të përcaktuar maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes së aktivit e zvogëluar me vlerën e tij të mbetur. Shuma e amortizimit kalon në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë lineare përgjatë jetës së aktivit.

3.4 Aktive të qëndrueshme materiale

1. NJOHJA DHE MATJA

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin, nëse ka, dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

2. AMORTIZIMI

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga data e vënies në përdorim. Aktivet e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe përqindjet e amortizimit të aktiveve afatgjata për periudhën 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

Mobilie dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje dhe programe IT	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Mjete transporti e të tjera	Mbi vlerën kontabël neto	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.5 Zhvlerësimi

3. AKTIVET FINANCIARE

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4. AKTIVET JOFINANCIARE

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ekzistojnë tregues të zhvlerësimit. Nëse ekzistojnë tregues të tillë, vlera e rikuperueshme vlerësohet.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit ose e njësisë së gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.6 Përfitimet e punonjësve

Fondet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe pensione

Bazuar në legjislacionin shqiptar, Shoqëria është e detyruar të paguajë në emër të punonjësve të saj kontribute të detyrueshme në një fond social të menaxhuar nga shteti. Pagesat dhe detyrimet e mbuluara nga Shoqëria njihen si shpenzime në periudhën të cilës ato i përkasin.

3.7 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.8 Njohja e të ardhurave

Shitja e shërbimeve

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.9 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare, huatë e dhëna dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.10 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në periudhën e raportimi.

Administrator

GLON BAKALLI



OPTIMA COMMUNICATION SHPK
PASQYRAT FINANCIARE 2014

(të gjitha vlerat janë të shprehura në LEKE, derisa nuk pasqyrohet ndryshe)

4. LIKUIDITETE DHE VLERA ARKE TE TJERA

Teprica e likuiditeteve për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si me poshtë:

	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Banka, llogari rrjedhëse	4.664.797	4.462.685
TOTAL	4.664.797	4.462.685

5. KËRKESA TE ARKETUSHME

Teprica e kërkesave të arkëtueshme për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si me poshtë:

	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Kliente	1.438.551	7.049.670
LI.A te tjera Tatim Fitim	1.293.883	6.525.880
Te tjere	8.268.156	3.495.164
TOTAL	11,000,591	17.070.714

6. INVENTARI

Teprica e Inventarit për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si me poshtë:

	Inventar	Total
Balanca me 01/01/2014	0.00	0.00
Transferime nga zëra të tjerë	0.00	0.00
Balanca me 31/12/2014	0.00	0.00

7. AKTIVE TE TJERA

Teprica e aktiveve të tjera për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si me poshtë:

	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Shpenzime të periudhave të ardhshme Parapagime	279.000	279.000
TOTAL	279.000	279.000

8. AKTIVET E QËNDRUESHME TE TRUPËZUARA

Teprica e AQT-ve për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si me poshtë:

	Pajisje zyre, moblie	Pajisje informatike	Mjete transporti	Totali i Aktiveve Fikse
AQT me kosto historike				
Teprica me 1 Janar, 2014	1.045.958	2.945.856	5.050.321	9.042.135
Shtesa nga blerjet	0.00	0.00	0.00	0.00
Transferime nga zëra të tjerë	0.00	0.00	0.00	0.00
Teprica me 31 Dhjetor, 2014	1.045.958	2.945.856	5.050.321	9.042.135
Amortizimi akumuluar				
Teprica me 1 Janar, 2014	385.428	1.655.463	438.895	2.479.786
Shtesa e vitit	132.106	322.598	922.285	1.376.990
Transferime nga zëra të tjerë	0.00	0.00	0.00	0.00
Teprica me 31 Dhjetor, 2014	517.534	1.978.061	1.361.180	3.856.775
Balanca me 31 Dhjetor, 2014	528.424	967.795	3.689.141	5.185.360

9. KAPITALI I PAPAGUAR

Teprica e Kapitalit të nënshkruar për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 është si me poshtë:

	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Kapital i papaguar	0.00	0.00
TOTAL	0.00	0.00

10. HUAMARRJET (AFATSHKURTËR)

Teprica e huamarrjeve për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 është si më poshtë:

	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Hua	0	0
Te Tjera	0	0
TOTAL	0.00	0.00

OPTIMA COMMUNICATION SHPK
PASQYRAT FINANCIARE 2014

(të gjitha vlerat janë të shprehura në LEKE, derisa nuk pasqyrohet ndryshe)

11. FURNITORË PËR BLERJE DHE SHËRBIME < 1 VIT

Teprica e furnitorëve për blerje dhe shërbime për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 është si me poshtë:

	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Furnitore	2.431.230	5.273.921
TOTAL	2.431.230	5.273.921

12. SHTETI TATIME DHE TAKSA ME < SE 1 VIT

Teprica e tatimeve dhe taksave për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 është si me poshtë:

	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Tatim Mbi te Ardhurat	33.460	26.530
Tatim fitimi	0	0
Sig Shoq & Shëndet	47.251	43.005
TVSH	66.232	438.932
Detyrime lokale	0	0
TOTAL	146.943	508.467

13. DETYRIME FINANCIARE AFAGJATA

Teprica e detyrimeve afatgjata për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 është si me poshtë:

	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Debitorë dhe Kreditore te tjerë	0	0
Detyrime ortakut	0	0
TOTAL	0.00	0.00

14. TE TJERA DETYRIME

Teprica e detyrimeve të tjera për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 është si me poshtë:

	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Debitorë dhe Kreditore te tjerë	0	0
TOTAL	0.00	0.00

OPTIMA COMMUNICATION SHPK
PASQYRAT FINANCIARE 2014

(të gjitha vlerat janë të shprehura në LEKE, derisa nuk pasqyrohet ndryshe)

15. KAPITALI I NËNSHKRUAR

Teprica e Kapitalit të nënshkruar për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 është si me poshtë:

	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Kapital i Nënshkruar	100.000	100.000
TOTAL	100.000	100.000

16. TE ARDHURA NGA SHITJET & TE ARDHURA TE TJERA

Teprica e të ardhurave nga shitja dhe të ardhurave të tjera për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 është si me poshtë:

	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Te ardhura nga shitja	10.163.449	24.784.257
Te ardhura të tjera	0	0
TOTAL	10.163.449	24.784.257

17. SHPENZIME PËR PERSONELI

Teprica e llogarisë personel për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 është si me poshtë:

	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Pagat	3.139.680	12.128.624
Sigurimet shoqërore	333.140	312.913
Total	3.472.820	12.441.534

18. FURNITURA, NËNTRAJTME DHE SHËRBIME

Teprica e furnitura, nëntrajtme dhe shërbime për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 është si me poshtë:

	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Shpënzime të tjera	642.522	430.494
Sherbim Palët e Treta	1.018.305	874.096
Trajtime të përgjithshme	1.589.156	1.441.206
Nënkontraktme të përgjithshme	1.661.759	15.838.289
Komisione Bankare	0	78.942
TOTAL	4.911.742	18.660.028

OPTIMA COMMUNICATION SHPK
PASQYRAT FINANCIARE 2014

(të gjitha vlerat janë të shprehura në LEKE, derisa nuk pasqyrohet ndryshe)

19. TE ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE

Teprica e te ardhurave dhe shpenzimeve financiare për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 është si me poshtë:

	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Te ardhurat Financiare	48.580	1.758
Shpenzimet Financiare	(9.341)	(18.653)
	(65.508)	
TOTAL	(26.269)	(16.895)

20. LLOGARITJE TATIM FITIMIT

Llogaritjet për Tatim fitimin për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 është si me poshtë:

	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Fitimi/ Humbja për Periudhën Para tatimit	375.628	(7.290.037)
Fitimi / (Humbja) Tatimore e mbartur	19.597.718	25.504.057
Shtese: Shpenzime te pa njohura b- Shpenzime te tjera te panjohura	544.861	1.383.156
Fitimi / humbja mbi te cilin llogaritet Tatimi	920.489	(5.906.881)
Tatim Fitimi I llogaritur 15%	138.073	0
Tatim Fitimi I parapaguar	1.431.957	1.144.461
Tatim Fitimi për tu arkëtuar / (paguar)	1.293.884	0

Administrator

GLON BAKALLI



OPTIMA COMMUNICATION SHPK
PASQYRAT FINANCIARE 2014

(të gjitha vlerat janë të shprehura në LEKE, derisa nuk pasqyrohet ndryshe)

Shoqeria Optima Communication Shpk
NIPT K71903025A

Aktivitet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2014

Nr	Emertimi		Gjendje 01/01/2014	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2014
1	Toka					0
2	Ndertime					0
3	Makineri,paisje Instalime		2,397,418	-		2,397,418
4	Mjete transporti		5,050,321			5,050,321
5	Mobilje Orendi		1,045,958			1,045,958
6	Paisje Infomatike		548,438			548,438
	TOTALI		9,042,135	0	0	9,042,135

Amortizimi A.A.Materiale 2014

Nr	Emertimi		Gjendje 01/01/2014	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2014
1	Toka					0
2	Ndertime					0
3	Makineri,paisje Instalime		1,504,666	223,188		1,727,854
4	Mjete transporti		438,895	922,285		1,361,180
5	Mobilje Orendi		385,428	132,106		517,534
6	Paisje Infomatike		150,797	99,410		250,207
	TOTALI		2,479,786	1,376,990	0	3,856,775

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2014

Nr	Emertimi		Gjendje 01/01/2014	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2014
1	Toka					0
2	Ndertime					0
3	Makineri,paisje Instalime		892,752	223,188		669,564
4	Mjete transporti		4,611,426	922,285		3,689,141
5	Mobilje Orendi		660,530	132,106		528,424
6	Paisje Infomatike		397,642	99,410		298,231
	TOTALI		6,562,350	1,376,990	0	5,185,360



(të gjitha vlerat janë të shprehura në LEKE, derisa nuk pasqyrohet ndryshe)

Inventari automjeteve ne pronesi te subjektit 2014

Administratori
GLON BAKALLI



(të gjitha vlerat janë të shprehura në LEKE, derisa nuk pasqyrohet ndryshe)

Shoqeria Optima Communication Shpk
NIPT K71903025A

Inventari ne pronesi te subjektit 2014

Nr.	Lloji i mallit	Cope	Cmimi	Vlera
Shuma				0

Administratori
GLON BAKALLI

